



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë (ME), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Vlera e pasurisë kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV) ishte mbivlerësuar për 10,000,000€, përderisa në anën tjetër ishin nënvlerësuar pasuritë jo kapitale nën 1,000€ për 22,185€.

A1 Detyrimet kontigjente të shpalosura në PFV ishin të nënvlerësuara për 4,741,404€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ME kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që

burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur

me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat që kërkojnë më tepër fokus janë menaxhimi i pasurisë dhe shpalosja e plotë dhe e drejtë e detyrimeve kontigjente. Në mungesë të kontrolleve efektive në këto fusha kemi një prezantim jo të saktë dhe të plotë të vlerave të raportuara në PFV.

Edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte arritur që të realizoj planin vjetor po ashtu njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plan të veprimit.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Prezantim jo i saktë i pasurisë në PFV

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, neni 13 i kësaj rregulloreje përcakton që: "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj".

Vlera e pasurisë e prezantuar në PFV nuk ishte e saktë dhe e plotë pasi që pasuria kapitale (mbi 1,000€) ishte mbivlerësuar për 10,000,000€, përderisa në anën tjetër pasuria jokapitale (nën 1,000€) ishte nënvlerësuar për 22,185€. Pa-rregullsitë e identifikuara janë si në vijim:

- Sipas marrëveshjes në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, ME ka mbështetur me mjete financiare prej 10,000,000€, "Programin mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale-Faza VI" prej vitit 2018. Projekti ka përfunduar në tetor të vitit 2022 me ç'rast është dorëzuar raporti përfundimtar nga investitori, por ende figuron në regjistrat e pasurisë së ME-së si investim në vijim, duke mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale në SIMFK.

Ministria ka bërë përpjekje për bartjen e pronësisë së këtyre projekteve, por nuk ka arritur për shkak të pa-qartësive në mes të

"Kompanive të Ujësjetës Rajonale" (përfutuese të projektit) dhe kompanisë që ka realizuar projektin (AP Dorsch/CDI), sa i përket kompletimit të dokumentacionit për bartje të pronësisë së projekteve. ME-ja në prill të 2023 kishte nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi për kalimin e pronësisë së investimeve kapitale me 6 KRU rajonale; dhe

- Pasuritë në vlerë 22,185€ për mobile dhe pajisje tjera të vendosura në qendrat e trajnimeve, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria, duke nënvlerësuar pasuritë jo kapitale në e-pasuria.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtari përgjegjës ka regjistruar vetëm pasuritë që janë pranuar përmes depos duke i anashkaluar pasuritë e pranuar në hapësira jashtë objektit të ministrisë.

Ndikimi Prezantimi jo i drejtë dhe jo i saktë i pasurive në pasqyrat financiare vjetore (PFV) dhe në regjistrat e pasurisë ndikon në vendimet e përdoruesve të informacioneve dhe në keq menaxhimin e saj.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpaleshet në PFV të jenë të sakta dhe të prezantohen pamje të drejta. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për organizatat tjera, të barten tek përfutuesit duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV)

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Vlera e prezantuar e detyrimeve kontingjente në PFV-të e ministrisë ishte e nënvlerësuar për 4,741,404€. Ne kemi konstatuar që ME kishte dy raste të hapura në proces gjyqësor për mos-paguesë të borxheve nga humbjet e "Shërbimit Universal Postar", njëri në vlerë 1,552,675€ (për borxhet e vitit 2016, 2017 dhe 2018) dhe tjetri në vlerë 3,188,729€ (për borxhet e vitit 2014, 2015 dhe 2016). Në të dy rastet kishte një Akt-vendim të Gjykatës Themelore dhe ankesa të parashtruara ndaj aktvendimit në Gjykatën e Apelit nga ana e palëve. ME nuk i ka shpaleshur këto raste si detyrime kontingjente në PFV duke i konsideruar të mbyllura, pa poseduar vendime finale nga Gjykata e Apelit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës të ministrisë dhe Avokaturës Shtetërore si dhe kontrolleve të dobëta në ministri lidhur me evidentimin, monitorimin dhe informimin rreth mbarëvajtjes së lëndëve në procese gjyqësore.

Ndikimi Mos-shpalesja e drejtë dhe e plotë e detyrimeve kontingjente ndikon që

palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me gjendjen e këtyre detyrimeve si dhe mund të ketë ndikim në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj që mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore, dhe të sigurohet se detyrimet kontingjente prezantohen drejtë dhe saktë në PFV-të e vitit 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A2 - Mos rikonfirmimi i fondeve në deklaratë

Gjetja

Ligji 04/L-042 për prokurim publik, neni 16.1. përcakton se vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë.

Po ashtu, neni 8.7 i RrUOPP specifikon që personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para publikimit të Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale.

Në tri raste kemi identifikuar se vlera e parashikuar është më e ulët se çmimi përfundimtar i kontratave:

- Për projektin "Furnizim me pajisje për Laboratorin e Institutit Gjeologjik të Kosovës", procedurat e prokurimit janë zhvilluar për 5 LOT dhe kanë rezultuar me kontrata të nënshkruara për 4 LOT. Vlera e parashikuar në "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e Disponueshmërisë së Fondeve" (DNPDF) dhe e ri konfirmuar se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht ishte 390,000€, kurse vlera totale e kontratave të nënshkruara ishte 497,009€. Pra vlera totale e furnizimeve në kontrata është për 107,009€ më e lartë se sa vlera e parashikuar në DNPDF.
- Kontrata "Furnizim dhe servisim i kondicionerëve të ME-së", kishte vlerë të parashikuar 15,000€ në DNPDF, kurse vlera e kontratës së nënshkruar ishte 21,880€. Pra vlera totale e kontratës është më e lartë për 6,880€ krahasuar me vlerën e parashikuar.
- Kontrata "Sigurimi i veturave për ME" kishte vlerë të parashikuar 21,000€ për tri vite, ndërsa vlera e kontratës së nënshkruar ishte 25,388€. Pra kemi tejkalim të vlerës së parashikuar për 4,387€.

Kjo ka ndodhur në mungesë të vëmendjes nga zyrtarët e autorizuar për verifikimin e saktë të vlerës së parashikuar, përkundër rikonfirmimit përmes komunikimeve elektronike këto ndryshime nuk ishin reflektuar në DNPDF.

Ndikimi

Mos ri-konfirmimi i fondeve të disponueshme për projekte të kontraktuara mund të ndikoj në hyrje të obligimeve të pa-planifikuara të ministrisë.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të siguroj se "Deklarata e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve" shqyrtohet nga personat e autorizuar për

nënshkrim të kontratave para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar ose në rastet kur ndodhin ndryshimet të paraqiten informacionet e modifikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV në fund të vitit 2022 është 19,320,535€, vlera e pasurive jokapitale është 23,007€ si dhe vlera e stoqeve 31,598€.

Çështja B2 - Mos-harmonizim i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4.1 i Rregullores MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që: Përgjegjësi e komisionit të inventarizimit është inventarizimi i të gjitha pasurive jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore.

Komisioni i inventarizimit pajisjet e IT-së për trajnime në vlerë 62,466€, të vendosura në objektin ku gjendet Infrastruktura e rrjetit Kosovar për Hulumtim dhe Edukim në Prizren dhe në Universitetin Publik "Haxhi Zeka" Pejë, nuk i kishte përfshirë në raportin e inventarizimit, ndërsa në regjistrin e pasurive kapitale janë të regjistruara në pronësi të ministrisë.

Mos inventarizimi i plotë i pasurive, ka ndodhur në mungesë të komunikimit në mes të zyrtarit përgjegjës dhe komisionit të inventarizimit për pronësinë e pasurive të vendosura në hapësirat e organizatave tjera.

Ndikimi Mos inventarizimi i plotë i pasurive ndikon në pamundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive, prandaj vlera e pasurive në PFV mund të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi B2 Ministrja duhet të sigurojë se komisioni për inventarizim të pasurisë ka informata të plota për të gjitha pasuritë që janë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë pavarësisht nga vendndodhja e tyre, si dhe pas inventarizimit të gjitha ndryshimet duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Ministria ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me një auditor. Gjatë vitit kjo njësi kishte finalizuar katër (4) auditime nga shtatë (7) sa i kishte në planin vjetor. Në këto raporte ishin dhënë 20 rekomandime të cilat e mbulonin vetëm 29% të periudhës aktuale dhe se për këto raporte mungonin planet e veprimit. Përderisa, Komiteti i Auditimit për vitin 2022 kishte mbajtur katër (4) takime pune.

Çështja A3 - Mangësi në funksionimin e NJAB-së

Gjetja Neni 23 i Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përcakton që: Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, siguron burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive; po ashtu siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në ME ka operuar me një auditor të përhershëm dhe një auditor të angazhuar deri në prill të vitit 2022. Nga shtatë auditime të planifikuara ishin realizuar vetëm katër në të cilat ishin dhënë 20 rekomandime.

Mos-realizimi i planit ka ndodhur për shkak se plani ishte hartuar duke u bazuar në staf prej dy auditorëve.

Ndikimi Mos përmbushja e planit të auditimit të brendshëm ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A3 Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Njëkohësisht të përmbushen objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës në përputhje me resurset në dispozicion.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^s	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	33,891,915	193,685,418	178,300,277	64,241,822	209,948,797
Grante Qeveritare – Buxheti	18,834,581	178,628,084	173,399,369	57,890,943	167,149,191
Financimi përmes huamarrjes	13,619,795	13,619,795	3,476,681	2,801,997	6,103,137
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	1,437,539	1,437,539	1,424,226	3,548,882	84,843
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	36,496,366
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	115,260

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 159,793,503€. Ky ndryshim në masë thelbësore vjen si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë në fushën subvencione dhe transfere për mbështetje në tejkalimin e krizës energetike, përkatësisht subvencionim të energjisë elektrike për konsumatorët fundor, kompensim të importit të energjisë si dhe mbështetje për ndërmarjet publike me vështirësi financiare.

Në vitin 2022 ME ka shpenzuar 178,300,277€ apo 92% të buxhetit final që paraqet një performancë më të mirë në raport me vitin paraprak ku niveli i realizimit ishte 84%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	33,891,915	193,685,418	178,300,277	64,241,822	209,948,797
Pagat dhe mëditjet	1,160,322	1,160,322	1,142,374	1,208,881	3,098,436
Mallrat dhe shërbimet	4,345,773	4,295,773	1,558,983	997,848	11,171,517
Komunalitë	23,130	23,130	11,333	7,783	64,553
Subvencionet dhe transferet	12,208,546	177,513,299	171,491,629	53,312,839	157,705,430
Investimet Kapitale	16,154,144	10,692,894	4,095,958	8,714,471	37,908,862

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar nuk kishte pësuar ndryshime dhe i njëjti ishte shpenzuar në masën prej 98%;

Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 50,000€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime. Në këtë kategori kemi një përqindje relativisht të ulët të shpenzimit ku buxheti është realizuar vetëm 36%. Kjo përqindje e ulët ishte pasojë e shtyrjes dhe mos-realizimit të projekteve me financim nga huamarrja. Bartës të buxhetit të financuar nga huamarrja ishin programet “Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike” (NJPMNP), Departamenti i Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë (DPTTI) dhe Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë (AKEE).

Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar nuk kishte pësuar ndryshime dhe ishte 23,130€. Ky buxhet ishte realizuar vetëm 49% si rezultat i mbulimit të disa shpenzimeve për këtë kategori nga departamenti përkatës i inxhinierisë së ish MAP.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 165,304,753€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve buxhetore me Vendime të Qeverisë në vlerë prej 165,954,753€ për zbatim të “Pakos së ringjalljes ekonomike” si dhe ndarjeve tjera buxhetore për mbështetje të ndërmarrjeve publike me vështirësi financiare. Po ashtu, nga kjo kategori janë deklaruar kursime në vlerë 1,000,000€ si dhe është bërë transfer i mjeteve në vlerë 350,000€ nga kategoria e investimeve kapitale nga “Projekti për ujë dhe kanalizim për zonat rurale të Kosovës” dhe është destinuar për mbështetje financiare të Ngrohtores së Gjakovës. ME kishte shpenzuar 171,491,629€ apo 97% të buxhetit nga kjo kategori. Ky shpenzim ishte për "Programin e ringjalljes ekonomike" 133,210,918€ dhe 38,280,711€ për subvencionim të NP me vështirësi ekonomike (KEK, Trepça Sh.A. KOSTT, Telekomit i Kosovës Sh.A, Infracos, Trainkos etj).


Sa i përket ndarjeve për “Programin e ringjalljes ekonomike”, nga kodi i projektit (00098) në kategorinë subvencione dhe transfere janë ndarë mjete në vlerë prej 135,400,000€ prej të cilave janë shpenzuar 133,210,918€.

Për zbatim të masës 3.7 “Mbështetje për tejkalimin e krizës energjetike”, janë shpenzuar 79,210,918€, prej tyre: 64,601,252€ për subvencionim të energjisë elektrike për konsumatorët fundor me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë (KESCO); 10,000,000€ për subvencionim të importit të energjisë elektrike (KEK); si dhe 4,609,666€ për subvencionim të efiçencës së energjisë për qytetarët përkatësisht blerjes së pajisjeve me nivel të lartë të efiçencës.

Ndërsa për zbatim të masës 4.6 “Mbështetje e ndërmarrjeve publike” janë shpenzuar 54,000,000€ për mbulimin e konsumit të energjisë elektrike (humbjeve jo teknike) në pjesën veriore të Kosovës për ndaljen e devijimeve dhe pagesën e borxhit të KOSTT ndaj sistemit interkonektiv evropian.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,461,250€ si rezultat i rregullimeve të brendshme dhe deklarimeve për kursim. Mjete në vlerë 350,000€ nga kjo kategori janë transferuar në kategorinë subvencione dhe transfere ndërsa shuma prej 5,111,250€ është deklaruar në kursime. Realizimi në raport me buxhetin final ishte vetëm 38%. Ky nivel i ulët i realizimit ishte pasojë e mos-realizimit të projekteve kapitale të planifikuara në mungesë të inicimit të kërkesave nga njësitë kërkuuese, ankesat nga operatorët ekonomik gjatë procesit të prokurimit si dhe shtyrjes së projekteve të financuara nga huamarrja.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga ME në vitin 2022 ishin 1,113€. Këto të hyra kanë të bëjnë me shërbimet që ofron Inspektorati i Energjisë që funksionon në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë. Këto të hyra shkojnë në llogarinë kryesore të Thesarit dhe nuk shfrytëzohen nga ME.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	356,048	356,048	1,113	2,400	1,157,999
Të hyrat jo tatimore	356,048	356,048	1,113	2,400	1,157,999

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar në katër (4) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, dy (2) rekomandime ishin zbatuar dhe dy (2) të tjera nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpaleshet në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2022 të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë.	Edhe këtë vit kemi identifikuar raste të njejta.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Ministria kishte ndërmarrë disa masa për të sistemuar këtë kategori të të punësuarve të cilët ishin evidentuar në listat fizike të ardhje-vajtjeve në punë.	I zbatuar

3.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.	Nuk janë ndërmarr veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë që për të gjitha investimet e realizuara në "Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve" në Prizren dhe për projekte tjera të ngjajshme të definohet pronësia e investimeve dhe njëherësh për pronat të cilat i takojnë institucioneve tjera të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme lidhur me bartjen e pronësisë në mënyrë që gjendja e pasurisë të prezantohet saktë si dhe të evitohet mundësia për keqmenaxhim të tyre.	Sa i perket çështjes së pronësisë rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli, Udhëheqëse e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Artane Rizvanolli
Ministre, Ministria e Ekonomisë
Data: 20 Prill 2023, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.